

**VENDIM**  
**Nr. 535, datë 27.6.2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË  
29.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LISTËN E PERSONAVE TË  
SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, e 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës "A" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", shtohen individët e renditur në shkronjën "a" të listës së shtuar të individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës "C" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "b" të listës së individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës "D" "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohen kompanitë e renditura në shkronjën "c" të listës së shtuar të kompanive në listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si bashkëpunëtorë ose financues për organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për kompanitë që janë bashkëpunëtoreshë ose financuese për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

a) **Lista e shtuar e individëve në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët":**

1. ADAM KHAN: ACHEKZAI;

b) **Lista e individëve të çregjistruar nga "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida":**

1. ABDUL MANAF: KASMURI;

2. ZULKEPLI: BIN MARZUKI;

3. WAN MIN: WAN MAT;

4. ZAINI: ZAKARIA;

5. MOHAMED: BEN MOHAMED: BEN KHALIFA: ABDELHEDI;

c) **Lista e shtuar e kompanive në "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida":**

1. ANSAR EDDINE.